



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:089629

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05683089

**Ac.nr.2299/2023**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti dhe Nora Bllaca Dula anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L..... Group SH.P.K, me seli në Malishevë, me pronarë M..... Th..... dhe H..... Th....., të përfaqësuar nga av H. P....., nga Klina, kundër të paditurve Z....B..... dhe A..... B..... nga Klina, të përfaqësuar nga Projusticia Laë Firm-avokatët E..... B..... dhe A..... S..... nga Prishtina, me objekt të kontestit pengim posedimi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurve të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë Dega në Klinë C.nr.300/22, të datës 14.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **08.05.2024** mori këtë:

A K T V E N D I M

**REFUZOHEN** si të pathemelta ankesat e të paditurve Z.....B..... dhe A..... B..... nga Klina, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë Dega në Klinë C.nr.300/22, i datës 14.02.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar C.nr.300/22, të datës 14.02.2023, ka vendosur në këtë mënyrë: **APROVOHET** padia dhe kërkesëpadia e paditësit L..... Group SH.P.K, me pronar M.... dhe H.... Th....., **SI E BAZUAR. VËRTETOHET** se të paditurit Z.... B..... dhe A..... B..... nga Klina, kanë kryer aktin e pengim posedimit dhe atë me datën 03.05.2021, ndaj paditësit për shfrytëzimin e parcelës nr.00392-1, ZK Klinë në pjesën veriore dhe në vazhdimësi të parcelës nr.00392-2, ZK Klinë në pjesën në drejtim të jugut në hapjen e rrugës në pjesën e këtyre parcelave që kufizohen me ngastrën kadastrale nr.00390-1 e cila është në emër të G..... B..... **I URDHËROHET** të paditurve Z..... B..... dhe A..... B....., që në të ardhmen të mos e pengojnë paditësin në shfrytëzimin e qetë faktik të pronës së tyre në parcelat Nr.00392-1, ZK Klinë, në pjesën veriore dhe në vazhdimësi të parcelës, Nr.00392-2, ZK Klinë, në pjesën në drejtim të jugut. Si dhe të mos e pengojnë në vendosjen e murit kufizues dhe hapjes së rrugës për nevojat e ndërtesës së ndërtuar në këto parcela. **DETYROHEN** të paditurit që në

emër të shpenzimeve procedurale të i'a paguaj paditësit shumën dhe atë siç vijon: Për padi 104 euro, taksë gjyqësore 40 euro, ekspertizë gjeodeete 360 euro, 6 seanca të mbajtura nga 135x6=810 euro, ku totali i shpenzimeve të procedurës është 1.314,00 euro. Pala paditëse për të realizuar dëmin me rastin e pengim posedimit udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, ankesë kanë paraqitur të paditurit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontesimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit të e ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet, apo t'a ktheje në rigjykim dhe rivendosje në këtë çështje kontestimore.

Pala paditëse nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

#### **Ankesa e palës së paditur është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 11.05.2021, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi për shkak të pengim posedimit kundër palës së paditur.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore, dhe ka administruar provat dhe ka vendosur si në dispozitiv të Aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të Aktvendimit të atakuar ndër të tjera theksohet se për të vërtetuar gjendjen faktike në kuptim të nenit 8 të LPK-së, bëri administrimin e provave si; Procesverbali i datës 05.10.2020, raporti i kushteve ndërtimore i datës 18.09.2020, skica e kushteve urbanistike pa datë e përpiluar ndaj N.... Sh....., vendimi i datës 24.09.2020, konfirmimi i pranimit të kërkesës për taksën për ndërtim i datës 22.09.2020, lista poseduese e datës 06.05.2021, shkresat e lëshuara nga L..... Group, të datës 05.05.2021, raporti i njësisë kadastrale i datës 30.06.2021, raporti gjeodet i datës 14.09.2021, nga eksperti J..... A....., tri foto, deklarata e dhënë nga M..... dhe L..... Sh.... e përpiluar tek av.Zef Marleku me datë 11.05.2021 e noterizuar me po të njëjtën datë, kontrata mbi shitblerjen në mes të M..... Sh..... dhe G..... B....., e datës 18.08.2014, historiat i datës 24.03.2021, kontrata e lidhur në mes të N..... Z..... shitës dhe M..... Th.....-blerës e datës 05.02.2018, kontrata e datës 18.09.2018, fotokopje e vërtetuar në gjykatë me datë 18.09.2008 dhe vërtetimi i datës 05.08.2019. Gjykata përshkruan se fillimisht për këtë çështje është vendosur me aktvendim C.nr.229/21, të dt.02.12.2021, i cili është atakuar me ankesë dhe lënda është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit me aktvendimin AC.nr.1016/2022, të dt.09.08.2022, kështu gjykata në rigjykim ka marr parasysh udhëzimet e Gjykatës së Apelit, dhe ka plotësuar dhe analizuar gjendjen faktike si më poshtë. Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi pasi që e njëjta ka bërë daljen në vend së bashku me ekspertin gjeometër dhe ka bërë verifikimin e ngastrave ku ka konstatuar se është bërë pengim posedimi me datë 03.05.2021, nga të paditurit gjë të cilën e kanë vërtetuar edhe vet të paditurit në deklaratimet e tyre të dhëna gjatë shqyrtimit kryesor ku kishin deklaruar se kanë penguar paditësin që të kryejë punën në parcelat me numër 00392-1 dhe 00392-2 ZK Klinë. Pengim posedimi nga ana e të paditurve është bërë në ngastrën kadastrale me

numër 00392- 1 ZK Klinë, në pjesën veriore dhe në vazhdimësi të parcelës nr.00392-2, ZK Klinë në pjesën në drejtim të jugut më saktësisht në hapjen e rrugës në pjesën e parcelave që kufizohen me ngastrën nr.00390-1, pronar i të cilës është G..... B..... ky fakt është vërtetuar me ekspertizën e gjeodezisë e punuar nga eksperti A.....N....., me datë 24.09.2021, për rastin 228/21, në të cilin paditës ka qenë G..... B.....familjar i të paditurve në rastin tonë ndërsa i paditur ka qenë L..... Group, për këtë qëllim në mënyrë që mos të shkaktohen shpenzime të pa nevojshme gjykata në shqyrtimin kryesor ka vendosur që këtë ekspertizë ta marrë në shiqim dhe t'ia bashkëngjisë lëndës për të argumentuar se në cilën pjesë të ngastrave ka ndodhur pengim posedimi nga ana e të paditurve. Po ashtu përmes deklarimeve të paditurve është vërtetuar se të njëjtit nga paditësit kanë kërkuar që nga parcelat apo ngastrat në fjalë ti blejnë dy ari mirëpo nuk kanë arritur pasi që paditësit nuk ia kanë shitur do të thotë nga ky fakt vërtetohet se paditësit kanë qenë në posedim dhe shfrytëzim të parcelave të cilat edhe janë pronë e tyre gjithashtu nga dalja në vend është vërtetuar se para se të ndodhte pengim posedimi nga të paditurit objekti ka qenë i ndërtuar komplet pjesa e vrazhdë dhe kur është dashur të hapet rruga për në objekt atëherë është kryer akti i pengim posedimit në pjesët e lartcekura. Gjithashtu është vërtetuar edhe një fakt ku në rastin konkret ka ndryshuar gjendja faktike dhe është hapur rruga për parcelat e paditësve dhe nga vet ky fakt del se të paditurit kan penguar paditësit , sepse komplet parcelelat paditësit i kan në posedim dhe shfrytëzim dhe në këto raste nuk janë penguar nga të paditurit dhe është vendos kufiri me rrjet dhe shtylla metalike e cila vërteton dhe përkufizon parcelën e paditësve. Sa i përket pretendimeve të palës së paditur gjykata i ka hedhur poshtë pasi që të njëjtit në asnjë mënyrë dhe me asnjë provë nuk kanë arritur që të kundër argumentojnë se nuk ka ndodhur pengim posedimi por të njëjtit çdo herë janë thirrur në atë se kanë kërkuar nga paditësi t'ia blejnë dy ari me një çmim të caktuar nga ai. Përveç kësaj të paditurit janë thirrur në atë se është një mur i ndërtuar më herët me anë të cilit bëhej kufizimi i parcelave që për këtë stad, si provë nuk mund të jetë pasi që gjykata ka të bëjë vetëm me atë se a ka pasur apo jo pengim posedim kurse palët janë thirr më tepër tek çështja e vërtetimit të pronësisë mirëpo kjo argumentohet me faktin se paditësit kanë pasur të lidhur kontratë mbi shitblerjen e parcelave të lartcekura të cilat dëshmohet se janë në emrin e paditësve si dhe në posedim dhe shfrytëzim të tyre dhe atë që nga data 05.02.2018. Sa i përket kërkesës për realizimin e dëmit me rastin e pengim posedimit gjykata nuk e ka gjykuar një kërkesë të tillë dhe ka udhëzuar palën në kontestin e rregullt civil. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së. Nga sa u tha më lartë në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 142.3 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë as pretendimet tjera ankimore të cekura në ankesë nga të paditurit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktvendimit është i qartë dhe i kuptueshëm dhe i përmbarueshëm dhe i hartuar në përputhje të

plotë me dispozitën e nenit 160, lidhur me nenin 175 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK). Në anën tjetër, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktvendimit.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese (ekspertizës gjeodezisë), dëgjimit të dëshmitarëve etj, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, siq është akti i pengim posedimit, mënyra e kryerjes së tij dhe koha. Andaj pretendimet e saj mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese që i ka cekur në arsyetim të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në lidhje me çështjen e cila është në shqyrtim, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se me nenin 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore (LPDTS), parashihet se "*Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë*", e në rastin konkret në bazë të provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se posedues i ngastrave 392-1 dhe 392-2 ZK Klinë është paditësi, dhe si e tillë ai ka të drejtë të plotë në posedim dhe shfrytëzimin e këtyre ngastrave. Gjykata e shkallës së parë më të drejtë ka konstatuar se paditësi e ka pasur pushtetin e fundit faktik në paluajtshmerinë kontestuese, e po ashtu është kryer akti i pengim posedimit nga të paditurit, në mënyrën e pretenduar nga paditësi.

Përveç të cekurave më lartë, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë me të drejtë me rastin e vendosjes është mbështetur në nenin 480 i LPK-së, i cili shprehimisht thotë se: "*Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit.*" Në pajtim me atë që kjo dispozitë përcakton, gjykata e shkallës së parë, pas marrjes së lëndës në shqyrtim e ka shqyrtuar dhe vërtetuar gjendjen e fundit të posedimit, përfshirë këtu edhe faktin se i padituri e ka kryer aktin e pengim posedimit në raport me paditësin. Si rrjedhojë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjshëm ka vendosur në këtë çështje kontestimore, kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke zbatuar me saktësi dispozitën e neneve 113.2, lidhur me nenin 114 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS), që tani është në fuqi, lidhur me nenin 480 të LPK-së, meqenëse është provuar fakti se i padituri e ka kryer aktin e pengim posedimit ndaj paditësit.

Duke marrë parasysh të lartëcekurat, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur, të theksuara në ankesën e parashtruar, ku përveç që i padituri nuk ka ofruar ndonjë bazë mbi të cilën Gjykata e Apelit do të vendoste ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, e njëjta, edhe për ato shkelje që i ka pretenduar, nuk ka dhënë sqarime të mjaftueshme, duke e bërë kështu ankesën të mangët në kuptim të nenit 178, pika c), të LPK-së.

Po ashtu drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur edhe lidhur me shpenzimet e procedurës dhe për këtë vërtetohet edhe ky vendim, për të cilin gjykata, me të drejtë, është mbështetur në nenin 452, të LPK-së.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palës së paditur, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Nga të lartëcekurat, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195.1, pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.2299/2023, me datë 08.05.2024**

**Kryetari i kolegjit,  
Ardian Ajvazi**